

Statistikat e Kulturës

Tremujori III - 2018


Tiranë, më 2 Nëntor 2018: Numri i shfaqjeve kulturore në tremujorin e tretë 2018 është 94, duke pasur një rritje me 42,4 % krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Në tremujorin e tretë 2018, numri i spektatorëve është 30.622 duke pësuar rritje me 73,0 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve / ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ ekspozitave	Tr.1- 2017	Tr.2- 2017	Tr.3- 2017	Tr.4- 2017	Tr.1- 2018	Tr.2- 2018	Tr.3- 2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.3 2017- Tr.3 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	36	43	8	56	44	36	15	87,5
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	12	21	5	61	24	34	8	60,0
Teatri Kombëtar Eksperimental	102	76	10	132	149	119	16	60,0
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	8	15	22	20	18	14	13	-40,9
Galeria Kombëtare e Arteve	2	5	3	7	0	1	1	-66,7
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	53	57	18	59	57	75	41	127,8
Shfaqje kulturore gjithsej	213	217	66	335	292	279	94	42,4

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e tretë të vitit 2018 është 326 spektatorë/vizitorë për shfaqje dhe ka pësuar rritje me 21,5 % krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje/ekspozitë



Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve /vizitorëve/audienca	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018	Tr.3-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.3 2017- Tr.3 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	12.310	12.575	3.617	19.888	13.963	8.833	5.748	58,9
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	7.779	16.693	4.583	28.000	12.256	10.709	6.600	44,0
Teatri Kombëtar Eksperimental	13.647	10.974	1.559	17.389	28.068	14.702	3.327	113,4
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	360	660	550	960	401	652	1.510	174,5
Galeria Kombëtare e Arteve	1.141	5.841	4.633	27.123	1.334	6.508	8.087	74,6
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	7.918	7.396	2.757	8.353	6.493	8.274	5.350	94,1
Numri gjithsej i spektatorëve	43.155	54.139	17.699	101.713	62.515	49.678	30.622	73,0

Në tremujorin e tretë 2018, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor ka realizuar 8 shfaqje kulturore në salla dhe ambiente të mbyllyra, me pjesëmarrje të 6.600 spektatorëve, duke shënuar një rritje prej 44,0 % në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017. Numri mesatar i spektatorëve gjatë tremujorit të tretë 2018 është 825 spektatorë për shfaqje, me një ulje prej 10,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Në tremujorin e tretë 2018, Teatri Kombëtar Eksperimental regjistron 16 shfaqje dhe 3.327 vizitorë, duke shënuar një rritje prej 113,4 % në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017.

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë ka realizuar numrin më të madh të shfaqjeve kulturore në tremujorin e tretë 2018 me 41 shfaqje, duke shënuar rritje me 127,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Ky institucion, në tremujorin e tretë të vitit 2018 ka shënuar një numër prej 5.350 vizitorësh duke pasur një rritje prej 94,1 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Numri mesatar i spektatorëve ishte 130 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rënie me 14,8 % krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017.

Në tremujorin e tretë 2018 Galeria Kombëtare e Arteve regjistron 8.087 vizitorë, duke shënuar një rritje prej 74,6 % në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017.

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit regjistron 1.510 vizitorë, me një rritje prej 174,5 % për tremujorin e tretë 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 3 Vizitorë në Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala

Numri i vizitorëve	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018	Tr.3-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.3 2017- Tr.3 2018)
Muze	13.327	56.375	78.479	52.805	24.477	104.382	114.721	46,2
Kala e monumente të tjera	12.962	58.059	102.621	27.506	18.075	97.508	154.650	50,7
Parqe arkeologjike	8.606	71.773	150.859	29.650	13.872	120.257	206.680	37,0
Numri i vizitorëve gjithsej	34.895	186.207	331.959	109.961	56.424	322.147	476.051	43,4

Numri gjithsej i vizitorëve në tremujorin e tretë të vitit 2018, paraqitur në tabelën nr. 3 është më i lartë në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017 duke pasur një rritje prej 43,4 %.

Numri i vizitorëve në muze, në tremujorin e tretë të vitit 2018 është 114.721 duke shënuar rritje me 46,2 % krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 50,7 %, ndërmjet tremujorit të tretë 2018 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2017.

Në tremujorin e tretë të vitit 2018 numri i vizitorëve në parqe arkeologjike është 206.680 me një rritje prej 37,0 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtar

Treguesit	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018*	Tr.3-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.3 2017- Tr.3 2018)
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	38.342	22.524	24.798	24.941	19.728	21.029	21.972	-11,4
Frekuentimi	35.707	26.294	29.552	32.150	18.662	22.628	17.305	-41,4
Numri i botimeve	4.874	3.322	2.851	5.464	4.222	2.861	1.917	-33,8
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	927	661	609	1.046	815	627	422	-30,7
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	3.947	2.661	2.242	4.418	3.407	2.234	1.495	-33,3

* Tremujori i 2 i vitit 2018 është i rregulluar për Bibliotekën Kombëtare me të dhënat e fundit.

Numri i shërbimeve të njësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibliotekës Kombëtare në tremujorin e tretë të vitit 2018 kanë pësuar rënie, respektivisht me 11,4 % dhe 41,4 % krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Në tremujorin e tretë 2018, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 1.917 botime, 33,8 % më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 422 ishin tituj të rinj dhe 1.495 ekzemplarë të rinj.

Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.